




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/22
Datë: 31/08/2021

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	2-170/2690
Nr. i faq.	1
Data	01/09/2021

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 31/08/2021 nxjerrë:

V E N D I M

Për

Bartjen e mjeteve nga kategoria ekonomike Rezerva në projektin e ri Asfaltimi i rrugës lokale Junik – Jasiq dhe miratimin e këtij projekti

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për Bartjen e mjeteve nga kategoria ekonomike Rezerva nga nen programi Administrata në nën programin Infrastruktura rrugore në projektin e ri **Asfaltimi i rrugës lokale Junik –Jasiq** dhe miratimin e këtij projekti kapital.

- Shuma prej **80,000.00 €** të bartet nga kategoria Rezerva në projektin e ri kapital **Asfaltimi i rrugës lokale Junik Jasiq**, në Programin Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca me kod 180, në nën Programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave, Punës dhe transfereve;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
Muharrem Krasniqi

Kryesues